

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

**UDHËZIME PËR VOTUESIT**

Të nderuar votues të Qendrës së Studimeve Albanologjike personel akademik, ju kujtojmë se:

- Zgjedhjet për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në QSA zhvillohen ditën e hënë, dt. 14.08.2017, ora 8<sup>00</sup>-16<sup>00</sup>
- Në QSA votohet në kater qendra votimi: në IH, në IA, në IGJL dhe në IAKSA.
- Qendra e votimit e Institutit të Historisë do të jetë Arkivi i Institutit të Historisë
- Qendra e votimit e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë do të jetë pranë ish-zyrës së drejtorit të këtij instituti, në godinën e IAKSA-s.
- Qendra e votimit e Institutit të Arkeologjisë do të jetë salla e pavijonit të prehistorisë, pranë Muzeut Arkeologjik
- Qendra e votimit e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit si dhe Qendrës Enciklopedike Shqiptare do të jetë zyra e drejtorisë së IAKSA.
- Kur votohet për Senatin Akademik (nga personeli akademik) duhet të votoni për dy kandidatë.
- Qendra Enciklopedike Shqiptare voton vetëm për Drejtor të përgjithshëm të QSA dhe për Anëtarë të Senatit Akademik.
- Të gjithë votuesit duhet të jenë të pajisur me kartë identiteti ose pasaportë biometrike të vlefshme. Në rast të kundërt humbasin të drejtën për të votuar.
- Vota është e fshehtë; ajo plotësohet vetëm në dhomat e fshehta, në rast të kundërt quhet e pavlefshme.
- Mund të votoni duke vendosur shenjat x ose + në kutinë në krah të kandidatit që doni të zgjidhet. Shenja duhet të vendoset brenda kutisë.
- Fletët e votimit, para se të hidhen në kuti, palosen në mënyrë që vulat të ngelen nga jashtë.
- Jini të vëmendshëm për instruksionet që ju japin anëtarët e KZI-ve gjatë procesit.

Në qendrën e votimit nuk lejohet:

- Të bëhet propagandë apo fushatë pro apo kundër kandidatëve.
- Të qëndrojnë persona që nuk janë votues apo të pa autorizuar nga KIZ –QSA-së.
- Të përdoren mjete digjitale për të fotografuar votën (celularë, aparate fotografike apo cdo mjet tjetër me funksion fotografimi).

**KIZ - QSA**

